



UNIVERSITETI I TIRANËS

KRITERET E PRANIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE DHE TË NJË PROGRAMI TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018 NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Kriteret e miratuara nga Universiteti i Tiranës, për pranimet në ciklin e parë të studimeve për Fakultetin e Ekonomisë për vitin akademik 2017-2018, janë si më poshtë:

I. Fakulteti i Ekonomisë

Kriteret e Pranimit të Studentëve të Ciklit të Parë të Studimeve në Fakultetin e Ekonomisë, UT, për vitin akademik 2017-2018 do të përbëhen nga 50% nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore, (mesatare e thjeshtë) dhe 50% nota mesatare e gruplëndëve (për të gjitha vitet ku shtrihen lëndët, përfshirë dhe notat e maturës shtetërore).

Sqarojmë se nëqoftëse Maturanti ka zhvilluar gjithsej 30 lëndë gjatë studimeve të shkollës së mesme plus 5 provime në maturën shtetërore (3 të detyrueshme dhe 2 me zgjedhje), 50% e vlerësimit total do të përbëhet nga kjo mesatare e thjeshtë:

$$M = \frac{N(1) + \dots + N(35)}{35}$$

2. Pika 2 e vendimit parashikon:

Në gruplëndë përfshihen lëndët e mëposhtme me peshat përkatëse:

- a) Matematikë, me një peshë 15%.
- b) Ekonomi, me një peshë 15%.
- c) Fizikë, me një peshë 10%.
- d) Gjuhë e Huaj, me një peshë 10%.

Për këto gruplëndë sqarojmë se:

a) **Matematikë, me një peshë 15%**. Nëse Maturanti ka zhvilluar edhe lëndë të tjera të gruplëndës “Matematikë”, si në listën më poshtë, do të merret mesatarja e thjeshtë e të gjitha notave të këtyre lëndëve, gjatë gjithë viteve të studimeve të shkollës së mesme, përfshirë dhe ato të maturës shtetërore.

1. Matematikë – E detyrueshme
2. Matematikë dhe elementët e statistikës
3. Matematikë dhe të dhënat e statistikës
4. Matematikë e avancuar
5. Matematikë e thelluar
6. Matematikë e zbatuar
7. Matematikë – kompjuter
8. Algjebër
9. Algjebër II
10. Algjebër trigonometri

b) **Ekonomi, me një peshë 15%**. Nëse Maturanti ka zhvilluar edhe lëndë të tjera të gruplëndës “Ekonomi”, si në listën më poshtë, do të merret mesatarja e thjeshtë e të gjitha notave të këtyre lëndëve, gjatë gjithë viteve të studimeve të shkollës së mesme, përfshirë dhe ato të maturës shtetërore.

1. Ekonomi e thelluar
2. Ekonomi e thelluar (Lëndë me zgjedhje)
3. Ekonomi e turizmit
4. Ekonomi e zbatuar
5. Ekonomi kombëtare
6. Ekonomi ndërmatrijeje
7. Ekonomi politike
8. Ekonomi shëndeti
9. Ekonomia dhe të drejtat
10. Ekonomia e personelit
11. Ekonomia e tatimeve
12. Ekonomi-Hyrje në Biznes
13. Ekonomiks
14. Njohuri për ekonominë
15. Parimet e ekonomisë.

c) **Fizikë, me një peshë 10%.** Nëse Maturanti ka zhvilluar edhe lëndë të tjera të gruplëndës “Fizikë”, si në listën më poshtë, do të merret mesatarja e thjeshtë e të gjitha notave të këtyre lëndëve, gjatë gjithë viteve të studimeve të shkollës së mesme, përfshirë dhe ato të maturës shtetërore.

1. Fizikë (lëndë me zgjedhje të detyruar)
2. Fizikë e avancuar
3. Fizikë e thelluar
4. Fizikë e zbatuar
5. Fizikë modul
6. Shkencë (që ka në përbërje lëndën (Fizikë))

d) Gjuhë e Huaj, me një peshë 10%.

Në gruplëndën “Gjuhë e Huaj”, përfshihen të gjitha lëndët e “Gjuhëve të huaja” të zhvilluara nga Maturanti.

Këto kritere janë përzgjedhur bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara në Fakultetin e Ekonomisë si dhe ato të shkollave jashtë vendit, si lëndë të rëndësishme në formimin e logjikës ekonomike dhe njohurive të nevojshme për vazhdimin e studimeve në Ekonomi dhe degët e profilet përkatëse.